



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 06.11.2023

NJOFTIM

Komuna e Gjakovës njofton se për festat e fundit ka planifikuar që të organizojë tregun e vitit të Ri 2024, në parkun e madh të qytetit, përkatësisht të Platoja.

Në tregun e vitit të ri 2024, do të vendosen shtëpizat, procedurat e shpërndarjes do të bëhen nga komisioni profesional, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht sipas Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim, për më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Komisioni do t'i ndjekë kriteret për ndarjen e hapësirave së bashku me shtëpizat siç përcaktohen me legjislacionin në fuqi, si dhe në bazë të kriterëve në vijim:

1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
2. Kopjen e letërnjoftimit;
3. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
4. Historiati i biznesit që aplikon;
5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
6. Vërtetimi nga komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë;
7. Vërtetimin e Taksës në Firmë;
8. Të jetë biznes që operon në Komunën e Gjakovës;
9. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku një (1) punëtor përveç pronarit;
10. Vërtetimin që dëshmon se i kanë të përfunduar të gjitha obligimet ndaj ATK-së.

- Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikim për marrjen në shfrytëzim të shtëpizave nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e komisionit.
- Aplikuesit që kanë obligime tjera të papaguara që do të evidentohen dhe vërtetohen nga komisioni në evidencat e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kërkesa refuzohet nga ana e komisionit.

- Në rast se dy apo më shumë aplikues/e aplikojnë për një shtëpizë me të gjitha kushtet e barabarta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre aplikuesve, në praninë e tyre dhe të Komisionit.
- Në rast se dy apo më shumë aplikues/e aplikojnë për një shtëpizë me të gjitha kushtet e barabarta, përparësi ka aplikues/ja e gjinisë me pak e përfaqësuar në parashtrimin e kërkesave.
- Aplikuesit kanë të drejtë të aplikojnë vetëm për një shtëpizë duke përcaktuar në formular sipërfaqen, në rast se evidentohet për dy apo më shumë aplikime kërkesat e tyre refuzohen.
- Komisioni do të përcaktojë lokacionin (vendosjen) e secilit përfitues të shtëpizave sipas planifikimeve për gjithëpërfshirje.

Tetëdhjetë (80) % e shtëpizave do të ndahen për bizneset që kanë aktivitet kryesor prodhimin e pijeve si dhe shërbimeve me pije. Ndërsa, pjesa tjetër e shtëpizave për aktivitete tjera që do të vlerësohen nga komisioni me qëllim të gjithëpërfshirjes së aktiviteteve shërbyese dhe prodhuese.

Një (1) shtëpizë do të ndahet për shoqatën për persona me aftësi të kufizuara.

Kompensimi për marrjen në shfrytëzim të një shtëpize sipas sipërfaqes do të jetë:

1. Shtëpiza me sipërfaqe (10) m² - 500 €, sasia 2 copë;
2. Shtëpiza me sipërfaqe (6) m² - 400 €, sasia 16 copë;
3. Shtëpiza me sipërfaqe (4.5) m² - 350 €, sasia 2 copë;
4. Shtëpiza me sipërfaqe (3) m² - 300 €, sasia 4 copë.

Të gjithë shfrytëzuesit obligohen që të mbajnë të hapur shtëpizat nga ora 12:00 deri në orën 24:00 çdo ditë, në të kundërtën Komuna do të shkëputë kontratën dhe të ndërmerr masa ligjore.

Afati për parashtrimin e kërkesave për marrjen në shfrytëzim të hapësirave – shtëpizave fillon nga data **07.11.2023** dhe përfundon me datën **14.11.2023**, në orën 15:00.

Kategoria e vetëfinancimit të ndërtimit të shtëpizave:

Meqë Komuna e Gjakovës në vitet paraprake ka pranuar kërkesa të shumta nga operatorët e interesuar për marrjen në shfrytëzim të shtëpizave në tregun e vitit të ri, pasi që Komuna nuk ka sasi të mjaftueshme për të gjithë të interesuarit, të njëjtit mund të aplikojnë për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e shtëpizave në tregun e vitit të ri përkatësisht në Platon e parkut të qytetit.

Operatorët që e ndërtojnë shtëpizën me mjetet vetanake, lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirave në tregun e vitit të ri, për vitet: 2024, 2025 dhe 2026 nëse shtëpizat e ndërtuara me vetëfinancim i dhurohen donacion Komunës së Gjakovës.

Formati – modeli i shtëpizave duhet të jetë i njëjtë me modelet që posedon Komuna e Gjakovës.

Me respekt!


Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës